

700P  
17.07.2026

## **SHPALLJE PËR LËVIZJE PARALELE PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINË EKZEKUTIVE**

**Specialist në Sektorin e Pronave Publike dhe Lishencave në Drejtorinë Juridike dhe Prokurimeve Publike pranë bashkisë Gjirokaštër**

**Kategoria e pagës IV-2**

Në zbatim të nenit 22 dhe të nenit 25, të Ligjit Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Kreut II, III, IV dhe VII, të Vendimit Nr. 243, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, Bashkia Gjirokaštër shpall procedurën e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil për pozicionin:

**Specialist në Sektorin e Pronave Publike dhe Lishencave në Drejtorinë Juridike dhe Prokurimeve Publike pranë bashkisë Gjirokaštër**

**Kategoria e pagës IV-2**

Pozicioni më sipër uiofrohen fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se nga këto pozicione, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende pozicioni është vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

**PËR TË DY PROCEDURAT (LËVIZJE PARALELE, PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL)  
APLIKOHET NË TË NJËJTËN KOHË!**

**Afati për dorëzimin e dokumentave për: LËVIZJE PARALELE  
31.07.2026**

**Afati për dorëzimin e dokumentave për: PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL  
06.08.2026**

### **Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin më sipër është:**

1. Zbaton me përpikmëri dhe në nivel të lartë profesional të gjitha detyrat e ngarkuara nga eprorët e tij;
2. Jep përgjigje ligjore dhe teknike për problemet specifike që mbulon sipas detyrave që i ngarkohen brenda sektorit, si dhe përgatit propozime lidhur me trajtimin e çështjeve të ndryshme me karakter profesional dhe teknik, sipas fushave që mbulon sektori;
3. Ndjek korrespondencën që i është dhënë për trajtim, duke respektuar rigorozisht afatet e përcaktuara. Përgatit materialin dhe pasi e siglon ia paraqet përgjegjësit të sektorit dhe drejtorit të drejtorisë;
4. Mban përgjegjësi për cilësinë dhe saktësinë profesionale të materialeve të përgatitura;
5. Të jetë pjesë e komisioneve të ndryshme të përcaktuar me urdhër të vecantë nga ana e titullarit të institucionit
6. Ndjek procedurat për pajisje me licenca, çertifikata për transport udhëtarësh për shërbimin e transportit urban, transporti rrethqytetës, dhe autovetura 8+1.
7. Ndjek procedurat për pajisje me çertifikata për shërbime transporti të udhëtarëve llogari të vet për kategorinë nxënës dhe student dhe për punonjës të subjekteve private dhe publike.
8. Ndjek procedurat për dhënien e licencave për agjencitë e transportit ndërkombëtare e transportit brenda vendit
9. Përgatit autorizime për mjetet që lejohen të qarkullojnë në qytet për banor, për shërbim të transportit të nxënësve dhe studentëve dhe për shërbim të transportit të punonjësve të subjekteve publike dhe private.
10. Përgatit autorizime për vendqëndrimin (miratuar me VKB) të mjeteve të agjencive turistike.
11. Ndjek procedurat për pajisje me licenca dhe çertifikata për transport malli për vehte dhe për të tretë brenda vendit.
12. Shqyrton shkresat me objekt ankese ose kërkesë drejtuar drejtorisë të të ardhurave dhe rekomandon përgjigjet përkatëse sipas legjislacionit në fuqi.
13. Administron dosjet përkatëse për subjektet të cilat janë lejuar për të shfrytëzuar burimet minerare për të vazhduar më tej me vjeljen e taksës përkatëse
14. Rakordon cdo fundmuaj me Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë Taksave dhe Përformancës
15. Zbaton Urdhëra pune për verifikimin në terren sipas rasteve dhe objekteve specifike.
16. Të jetë pjesë e komisioneve të ndryshme të përcaktuar me urdhër të vecantë nga ana e titullarit të institucionit

#### **1. LËVIZJA PARALELE**

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

#### **1.1**

### **KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJNË KANDIDATËT PËR LEVIZJE PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA**

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a) Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori;
- b) Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c) Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a) Te kete të paktën diplomën në nivelin minimal Bachelor në shkencat natyrore., Master Shkencor, Master Profesional në po të njëjtën fushë të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike”.(Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi)
- b) Të kenë eksperiencë pune jo më pak se 3 vite në administratën shtetërore dhe/ose institucione të pavarura .
- c) Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.
- d) Të zotërojnë gjuhën angleze. Përparësi ka një gjuhë e dytë e BE-së

## **1.2 DOKUMENTACIONI, MENYRA DHE AFATI I DOREZIMIT**

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

1. Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>
2. Fotokopje e noterizuar të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
3. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
4. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
5. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
6. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.
7. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
8. Vërtetim nga Institucioni që nuk ka mase disiplinore në fuqi;
9. Çertifikatë familjare;
10. Çertifikatë personale;
11. Cdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

*Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 31.07.2026. në Bashkinë Gjirokastrë.*

## **1.3 REZULTATET E VERIFIKIMIT PARAPRAK TË DOKUMENTACIONIT**

Në datën 04.08.2026 NJMBNJ do të shpallë në portalin e “Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive” dhe në stendat e Bashkisë, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e

posaçme për procedurën e lëvizjes paralele, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet intervista. Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e posaçme, do të njoftohen individualisht nga NJBMNJ, (nëpërmjet adresës së e-mail), për shkaqet e moskualifikimit.

#### **1.4 FUSHA E NJOHURIVE MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA**

1. Ligji Nr. 139/2015 “Per vetëqeverisjen vendore”
2. Njohuritë mbi Ligjin Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij.
3. Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në Administratën Publike”
4. Ligji Nr.8308, datë 18.3.1998 Për Transportet Rrugore.
5. Vendim Nr. 325, Datë 19.3.2008 Për Miratimin E Rregullave Për Pranimin Në Veprimtarinë E Operatorit Të Transportit Rrugor Të Mallrave Dhe Të Udhëtarëve, Si Dhe Për Njohjen E Dokumenteve Zyrtare, Të Caktuara Për Këta Operatorë.

#### **1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar. Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe çertifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i çertifikimit nuk është kryer. Totali i pikëve për këtë vlerësim **është 40 pikë**. Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim **është 60 pikë**. Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike.

#### **1.6 DATA E DALJES SË REZULTATIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, NJBMNJ do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në portalin “Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga NJBMNJ, për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

### **2. PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL**

Vetëm në rast se nga pozicionet e renditura në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicione vakante, këto pozicione janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimin në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive. Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

**2.1****KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA**

---

**Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimi në shërbimin civil janë:**

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënua me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas Ligjit Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

**Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:**

- a) Te kete të pakten diplomën në nivelin minimal Bachelor në shkencat natyrore, Master Shkencor, Master Profesional në po të njëjtën fushë të përfutur në fund të studimeve të ciklit të dytë, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike”. (Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi)
- b) Të kenë eksperiencë pune jo më pak se 1 vit në administratën shtetërore dhe/ose institucione të pavarura .
- c) Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.
- d) Të zotërojnë gjuhën angleze. Përparësi ka një gjuhë e dytë e BE-së

**2.2****DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

---

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë Dokumentet si më poshtë:

- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://ëëë.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>
- Fotokopje të diplomës Master e cila duhet te jete e te njejtës fushe (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- Çertifikatë familjare
- Çertifikatë personale
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton mesataren e ponderuar të diplomës (listë notash, vërtetim nga fakulteti), trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 06.08.2026 në Bashkinë Gjirokastrë.

*Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në shërbimin civil, do të informohen për fazat e mëtejshme të kësaj procedure:*

Për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi si dhe mënyrën e vlerësimit të kandidatëve.

### **2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

Në datën 17.08.2026, Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të Bashkisë Gjirokastrë ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni do të shpallë në portalin e “Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive” listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

### **2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA**

1. Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”
2. Njohuritë mbi Ligjin Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij.
3. Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në Administratën Publike”
4. Ligji Nr.8308, datë 18.3.1998 Për Transportet Rrugore.
5. Vendim Nr. 325, Datë 19.3.2008 Për Miratimin E Rregullave Për Pranimin Në Veprimtarinë E Operatorit Të Transportit Rrugor Të Mallrave Dhe Të Udhëtarëve, Si Dhe Për Njohjen E Dokumenteve Zyrtare, Të Caktuara Për Këta Operatorë.

### **2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

**Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:**

- Vlerësimin me shkrim, deri në 60 pikë;
  - Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 25 pikë;
  - Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë;
- Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike [ëëë.dap.gov.al](http://ee.dap.gov.al)

<http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

**2.6**

## **DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Gjirokastrë do të shpallë fituesin në portalin e “Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për rezultatet.

**2.5**

## **MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

**Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:**

- Vlerësimin me shkrim, deri në 60 pikë;
- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 25 pikë;
- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë;

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike [ëëë.dap.gov.al](http://dap.gov.al)

<http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

**2.6**

## **DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Gjirokastrë do të shpallë fituesin në portalin e “Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për rezultatet.

**DREJTOR**

**Mirlinda Shabani**

